

Raporti i veprimtarisë së ASPA-s për vitin 2014

Shkurt 2015



Adresa: Bulevardi Zhan D'Ark Nr 31, Tiranë

Tel/Fax: +355 4 2271860

www.aspa.gov.al email: aspa@aspa.gov.al

Përmbajtja:

➤ Realizimi i planit të trajnimit në mbështetje të prioriteteve të Qeverisë Shqiptare.....	3
➤ Objektivat kryesorë strategjikë të zhvillimit institucional	4
➤ Programi i trajnimit	6
➤ Indikatorët e trajnimit për periudhën Janar- Dhjetor 2014.....	8
➤ Mbështetje Institucionale dhe Financiare	9
➤ Bashkëpunimi me Institucione Kombëtare dhe Ndërkombëtare.....	10
➤ Menaxhimi financiar.....	13
➤ Konkluzione.....	14
Aneks : Lista e trajnimeve të realizuara gjatë vitit 2014.....	15



Realizimi i planit të trajnimit në mbështetje të prioriteteve të Qeverisë Shqiptare

Viti 2014 për Shkollën Shqiptare të Administratës Publike, ka qënë një periudhë pune intensive, me qëllim organizimin e aktiviteteve trajnuese për rritjen e kapaciteteve të administratës. Një rol shumë të rëndësishëm në orientimin e aktiviteteve të ASPA, pati hyrja në fuqi e ligjit 152/2013 "Për nëpunësin civil", si edhe e vendimit Nr. 138 datë 12.03.2014 mbi "Rregullat e organizimit e të funksionimit të shkollës shqiptare të administratës publike dhe trajnimin e nëpunësve civilë". Këto dy akte janë themelore dhe shërbejnë si bazë për përcaktimin e fushës së veprimatrisë objektive, dhe mënyrës së funksionimit të ASPA.

Veprimtaria e ASPA-s gjatë kësaj periudhe kohore është zhvilluar bazuar në:

- Objektivat e përcaktuar në planin strategjik
- Mbështetjen e realizimit të objektivave strategjike të qeverisë
- Strategjinë kombëtare për zhvillim dhe integrim

Fokusi kryesor i punës në këtë periudhë ka qënë rritja e kapaciteteve të administratës publike në drejtim të përgatitjes së vendit për anëtarësimin në Bashkimin Evropian. Në këtë kuadër, është bashkëpunuar ngushtësisht me donatorë dhe programe si SMEI III, PPF, TAIEX, GOA; SIGMA etj, të cilat kanë qënë partnerët tanë në këto aktivitete.

E parë në këtë këndvështrim, aktivitetet trajnuese janë orientuar në këto drejtime:

○ **Lufta kundër korrupsionit**

Një nga prioritetet e qeverisë sonë është lufta kundër korrupsionit. Raporti i Progresit i Komisionit Evropian vlerëson përpjekjet e ndërmarra dhe thekson një përmirësim të perceptimit të luftës kundër korrupsionit. Trajnimet e zhvilluara në këtë fushë kanë përfshirë si nivelin qendror edhe atë lokal, me tematikë "Çështje të etikes dhe të antikorrupsionit në Administratën Publike", trajnime të cilat janë zhvilluar gjatë vitit 2014.

Në total janë zhvilluar 24 trajnime me këtë tematikë në nivel qendror dhe lokal, dhe janë trajnuar 648 nëpunës civilë.

○ **Decentralizimi**

Në mbështetje të prioriteteve të qeverisë, ASPA ka zhvilluar edhe workshopin me temë "Rritja e efektivitetit në procesin e decentralizimit dhe reformës territoriale në Shqipëri 12-14 Maj 2014, dhe morën pjesë 22 pjesëmarrës.

Ky aktivitet është realizuar falë një bashkëpunimi të suksesshëm ndërmjet Ministrit të Çështjeve Vendore dhe Decentralizimit, me mbështetjen e DeLoG (Grupi i Punës i Partnerëve për Zhvillim që punojnë në Decentralizim dhe Qeverisje Vendore) dhe Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASPA).



Adresa: **Bulevardi Zhan D'Ark Nr 31, Tiranë**

Tel/Fax: +355 4 2271860

www.aspa.gov.al email: aspa@aspa.gov.al

○ **Trajnime lidhur me procesin e Integritit në Bashkimin Evropian.**

Trajnimet që lidhen me procesin e integritit European të Shqipërisë, ka qënë dhe mbetet një nga fushat më të rëndësishme të trajnimit të administratës publike. ASPA ka punuar në vazhdimësi gjatë gjithë kësaj periudhe në bashkëpunim me projektet SMEI III e PPF për organizimin e trajnimeve në këtë fushë. Tematikat e trajnimeve kanë qënë: Menaxhimi i ciklit të projektit, Procedurat e prokurimit dhe menaxhimi i fondeve IPA, Drejtësia dhe siguria, Politikat rajonale dhe bashkërendimi i instrumentave, Politikat sociale dhe të punësimit, Hartimi i Termave të referencës (TOR), Prokurimi i punëve, Prokurimi i mallrave, Marrveshja Kuadër, Prokurimi i shërbimeve sipas standarteve të BE-së, Politikat sektoriale të BE-së etj.

Një vend të veçantë kanë zënë këto trajnime gjatë vitit 2014, bazuar edhe në prioritetin e veçantë që pati dhe që u kurorëzua me marrjen e statusit të vendit kandidat. Kështu gjatë vitit 2014 trajnimet në këtë fushë kanë zënë 19.6 % të totalit të trajnimeve.

☉ **Objektivat kryesorë strategjikë të zhvillimit institucional**

✓ *Krijimi i një institucion të orientuar më shumë drejt klientit.*

Viti ka 2014 ka qënë një vit intensiv, për Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASPAs). Zhvillimi i aktiviteteve të institucionit është orientuar në dy drejtime kryesore:

1. Zbatimi i strategjisë duke zbatuar programin e trajnimit në përputhje me nevojat reale të Administratës Publike;
2. Krijimi dhe konsolidimi i ASPA-s, si institucion i ngritur në bazë të ligjit 152/2013 “ për nëpunësin civil”

Për realizimin e këtij objekti është punuar në disa drejtime:

- Rritja e efektivitetit dhe cilësisë së trajnimit;
- Rritja e kapaciteteve të brendshme;
- Shfrytëzimi efikas i ambienteve dhe pajisjeve të trajnimit;
- Rritja e vizibilitetit të ASPA;
- Krijimi dhe konsolidimi i një rrjeti bashkëpunorësh të brendshme dhe të jashtëm;
- Rritjen e kapaciteteve të brendshme, me qëllim përfshirjen e vetë stafit në zhvillimin e disa programeve bazike të trajnimit.

✓ *Rritja e rolit të Institucionit në zhvillimin e programeve të trajnimit të financuara nga ndihma e huaj.*

Gjatë kësaj periudhe, është punuar në bashkëpunimin me projekte të financuara nga donatorë: “Project Preparation Facilities” PPF, “Support to the EU Integration Process” SMEI III, “Organisation for Security and Cooperation in Europe” – OSCE, GOA, SIGMA. Trajnimet e zhvilluara në kuadër të këtyre bashkëpunimeve kanë qënë të tematikave të tilla si: Procedurat e prokurimit dhe prokurimi i fondeve të IPA - PRAG ; Drejtësia, liria dhe siguria; Politikat rajonale dhe bashkërendimi i instrumentave strukturore; Prokurimi sipas BE dhe menaxhimi i kontratave; Menaxhimi i parregullsive dhe i riskut Hartimi i Termave të Referencës për Projektet IPA PPF; Ligji për nëpunësin civil si edhe një sërë trajnimesh sipas kapitujve të veçantë për anëtarët e grupeve ndërministrorë.



Adresa: **Bulevardi Zhan D'Ark Nr 31, Tiranë**

Tel/Fax: +355 4 2271860

www.aspa.gov.al email: aspa@aspa.gov.al

Duhet theksuar se ASPA, në realizimin e këtyre trajnimeve ka luajtur një rol të rëndësishëm, si partner dhe organizator duke bërë të mundur një koordinimin efikas të burimeve dhe nevojave për trajnime.

- ✚ Një vend të veçantë gjatë vitit 2014, ka patur edhe organizimi i dy aktiviteteve shumë të rëndësishme për stafin ASPA: organizimi i një misioni ekspertësh mbi hartimin e programit të për nivelin drejtues të nëpunësve civilë, aktivitet i cili u zhvillua në datat 9-25 Maj 2014 ; si edhe organizimi i një Workshop-i lidhur me metodologjinë e trajnimit, si një faktor shumë i rëndësishëm për rritjen e cilësisë të shërbimeve që ASPA ofron. Të dyja këto aktivitete u zhvilluan me mbështetjen e Këshillit të Evropës, në kuadër të programit TAIEEX, dhe i shërbyen më së miri rritjes së frymës së bashkëpunimit dhe punës në skuadër, si edhe rritjes së kapaciteteve të brendshme të stafit të ASPA-s.

- ✚ Duke filluar nga 7 Prill 2014, për një periudhë 6 javore , në ambientet e ASPA-s u zhvillua trajnimi për nivelin e lartë drejtues në të cilin morën pjesë të sekretarët e përgjithshëm të ministrive të linjës. Ky trajnim kishte objektivi rritjen e kapacitetve dhe aftësive drejtuese dhe menaxhuese të nivelit të lartë drejtues në administratën drejtuese. Tematikat e këtij modulu përfshinë: Menaxhimi dhe ndryshimi ; Komunikimi i brendshëm në administratën publike; Marrdhëniet me Publikun; Parimet dhe Objektivat e Administratës Moderne në Mjedisin Administrativ Evropian; Etika në administratën publike; Çështje të Integritimit Evropian.

- ✚ Periudha 31 Mars-04 Prill 2014, përkon me periudhën e organizimit të trajnimit të Trajnereve në ASPA. Ky cikël trajnimi pati si qëllim përgatitjen e një grup trajnerësh që do të shërbenin si bazë për trajnimin e nëpunësve të administratës publike në nivelin qëndror. ASPA siguroi të gjithë mbështetjen për organizimin dhe zhvillimin e trajnerëve që nga përgatitja e kurrikulës, përzgjedhja e lektorëve, logjistika e trajnimit dhe vlerësimin e njohurive në fund të trajnimit. Në këtë trajnim morën pjesë 43 nëpunës civilë të përzgjedur nga ministrinë e linjës, të cilët i përkisnin niveli të mesëm dhe të ulët drejtues, dhe u trajtuan këto module: Komunikimi i brendshëm në administratën publike; Marrdhëniet me Publikun; Ligji i Nëpunësit Civil; Etika në administratën publike; Çështje të Integritimit Evropian.

Në përfundim të ToT-së, nëpunësit trajnuar u aktivizuan si trajnerë në trajnimet që u organizuan në ministrinë e linjës. Trajnimet e organizuara në këtë kuadër u asistuan dhe monitoruan nga ASPA në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve njerëzore të çdo institucioni. **Në total në gjithë ministrinë e linjës janë trajnuar 5664 nëpunës civilë.** Performanca e pjesëmarrësve është vlerësuar në bazë të një testimi para dhe pas trajnimit. Sipas rezultateve të këtij testimi është vërejtur që trajnimi ka qenë i domosdoshëm për nëpunësit civil të të gjitha niveleve. Në disa Ministri vërehet një rritje me 50% e performancës së nëpunësve pas procesit të trajnimit ndërkohë që në të gjitha Ministrinë vërehet se indikatorët e rritjes së performancës janë pozitivë.



Adresa: **Bulevardi Zhan D'Ark Nr 31, Tiranë**

Tel/Fax: +355 4 2271860

www.aspa.gov.al email: aspa@aspa.gov.al

Programi i trajnimit

- Objektivi kryesor i programit të trajnimit ka qënë:

Të mbështesë një shërbim civil më profesional, të aftë dhe të bazuar në sistemin e meritës, menaxher më të kualifikuar dhe më të përgjegjshëm si dhe një shërbim civil më cilësor dhe më të motivuar për të zbatuar strategjitë kombëtare për zhvillime të mëtejshme në të ardhmen.

Në këtë funksion është hartuar një plan trajnimi i cili përveçse është bazuar në prioritetet e institucionit ka qënë shumë fleksibël, me qëllim realizimin në kohë të nevojave për trajnim.

1. Trajnime që lidhet me procesin e Integrimit Evropian

Procesi i marrjes së statusit të vendit kandidat për në Bashkimin Evropian shoqërohet me shumë reforma dhe angazhime. Roli i ASPA-s është të mbështesë këto zhvillime, duke rritur kapacitetet e administratës publike shqiptare, me qëllim rritjen e efektivitetit të punës dhe rritjen e cilësisë së shërbimit në fushën e aplikimit, menaxhimit dhe monitorimit të fondeve të BE-së.

Për të rritur kapacitetet e nëpunësve të Institucioneve qendore dhe lokale në programimin dhe zbatimin në të ardhmen e sistemit të decentralizuar të asistencës së BE-së, tashmë me një qasje të re sektoriale, janë organizuar trajnime për nëpunësit që punojnë me hartimin e projektpropozimeve, programimin dhe monitorimin e asistencës së BE-së. Pjesëmarrja e stafit të ministrive të linjës dhe institucioneve të tjera qendrore në këto trajnime është një garanci më shumë për të patur projekte të mirëpërgatitura, duke plotësuar kështu edhe një kërkesë të BE-së: rritjen e pronësisë së përfituesve për programimin dhe menaxhimin me efektivitet të fondeve të IPA-s. Në organizimin e trajnimeve në këtë fushë, është bashkëpunuar më projekte si PPF,

Tematikat kryesore në këtë fushë : Prokurimi sipas procedurave të BE-së dhe menaxhimi i kontratave ; Hartimi i termave të referencës për Projektet IPA; Trajnime mbi Kapituj të veçantë të EU -acquis ; Monitorimi dhe vlerësimi i Fondeve IPA etj.

Për vitin 2014 janë zhvilluar: 33 kurse, 45 ditë trajnimi dhe janë trajnuar 537 nëpunës civilë.

2. Trajnime në mbështetje të strategjisë së decentralizimit

Qëllimi i trajnimeve në këtë fushë është zhvillimi i kapaciteteve të administratës lokale duke nxitur bashkëpunimin komunal nëpërmjet shkëmbimit të eksperiencave më të mira/modeleve që ekzistojnë në vend. Në këtë fushë është punuar si me mbështetjen e buxhetit të shtetit, ashtu edhe me programe e projekte.

- Në datat 12-14 Maj 2014 në ambientet e ASPA u zhvillua trajnimi “Rritja e efektivitetit në procesin e decentralizimit dhe reformës territoriale në shqipëri”

Kursi i trajnimit është përqëndruar në trajtimin e :
- reformës së decentralizimit ;



Adresa: **Bulevardi Zhan D'Ark Nr 31, Tiranë**

Tel/Fax: +355 4 2271860

www.aspa.gov.al email: aspa@aspa.gov.al

- reformës territoriale ;
- marrëdhënies me qeverinë në nivel qendror e vendor ;
- partnerët zhvillues në decentralizimin dhe qeverisjen vendore-DeLoG
- Decentralizimi Fiskal ;
- Qeverisja vendore dhe aderimi në BE ;
- Monitorimi i strategjisë së decentralizimit.

Pjesëmarrës në këtë aktivitet ishin dhe nëpunës të pushtetit vendor të cilët kanë marrëdhënie të dretpërdrejta me çështjet e reformës në pushtetin vendor (Bashkia Durrës, Pogradec, Berat, Komuna Synej, Bashkia Elbasan, Korçë, Vlorë dhe Burrel), drejtues kyç nga Institucionet qendrore (Ministria e Financave, Ministria e Brendshme, MZHUT, FSHZH) si dhe përfaqësues nga shoqëria civile (Cooperazione Italiana, KiE, DLDP, UNDP, Ambasada Zvicerrane).

Gjithashtu, një rëndësi e veçantë i është kushtuar trajnimeve lidhur me “Etikën dhe antikorrupsionin në Administratës publike”; një sërë trajnime janë zhvilluar me nëpunës civilë vendorë të Fierit, Vlorës, Beratit, Dibërës, Korçës, Gjirokastrës etj.

Vetëm gjatë periudhës Janar- Korrik 2014 janë zhvilluar 12 kurse trajnimi dhe janë trajnuar 312 nëpunës civilë.

Tematika të tjera të rëndësishme të zhvilluara gjatë vitit 2014 ishin; Barazia gjinore; Buxhetimi i përgjegjshëm gjinor etj, Menaxhimi i mbetjeve; rritja e efektivitetit në procesin e decentralizimit dhe reformes territoriale në shqipëri, Prezantime me administratën publike në nivel lokal.

Gjatë vitit 2014 , në nivelin vendor janë zhvilluar 26 trajnime, 42 ditë trajnimi dhe janë trajnuar 668 nëpunës civilë të nivel lokal.

3. Trajnime të përgjithshme

Programi i trajnimit ofron njohuri mbi organizimin dhe funksionimin e administratës publike, procesin e hartimit të politikave dhe zbatimin efektiv të tyre, zhvillimin e aftësive menaxhuese të orientuara drejt rezultateve të nëpunësve civilë.

Prezantimi me Administratën Publike - ky program trajnimi, është i detyrueshëm për nëpunësit që janë në periudhë prove. Ky trajnim i njeh pjesëmarrësit me disa koncepte themelore mbi organizimin dhe funksionimin e administratës publike dhe shtetit Shqiptar, procedurat administrative, pa lënë mënjanë dhe aftësitë profesionale dhe menaxheriale që duhet të këtë nëpunësi civil në përputhje me kërkesat e kohës. Gjatë këtij viti është punuar më shumë intensitet në organizimin e këtij trajnimi, kjo për vetë veçorinë e hyrjes në fuqi të Ligjit 152/20123 “ Për nëpunësin Civil”. Trajnimet e zhvilluara kanë qënë të fokusuara në nivel qendror, duke përfshirë nëpunës të Institucioneve qendrore, Kontrollit të lartë të Shtetit , ILDKP etj.

Kështu gjatë vitit 2014 janë zhvilluar 28 kurse Trajnimi, 280 ditë trajnimi dhe janë trajnuar në total 863 nëpunës civilë . Këto trajnime kanë zënë rreth 17% të kurseve të organizuara dhe rreth 23 % të numrit të përgjithshëm të nëpunësve civilë të trajnuar .

Në këtë fushë janë zhvilluar edhe trajnime me tematika si: Hartimi i shkresave zyrtare, Mbrojta e të dhënave personale; Ligji për nëpunësin civil; Etika dhe konflikti i interesit në administratën publike; Siguria kompjuterike; Zbatimi i sistemit të drejtësisë në shqipëri; Ndërgjegjësim dhe aftësim i



Adresa: **Bulevardi Zhan D'Ark Nr 31, Tiranë**

Tel/Fax: +355 4 2271860

www.aspa.gov.al email: aspa@aspa.gov.al

Administratës Publike në fushën TIK etj; Mbrojta e të dhënave personale; Zbatimi i sistemit të drejtësisë ne Shqipëri etj.

Trajnime të përgjithshme për periudhën Janar- Dhjetor 2014: Janë zhvilluar në total 59 kurse trajnimi; 315 ditë trajnimi dhe janë trajnuar 1525 nëpunës civilë.


3. Trajnime në fushën e menaxhimi financiar dhe planifikimi dhe planifikimi strategjik

Kjo fushë trajnimi, edhe pse e kufizuar për shkak të fluksit të madh të trajnimeve në fushat e mësipërme, ka patur një rëndësi të veçantë, sa i takon tematikave dhe pjesmarjes së nëpunësve civilë. Kështu tematika me shumë interes kanë qënë: Prokurimi publik, prokurimi i mallrave, Prokurimi i shërbimeve ; Marrëveshja kuadër; Menaxhimi i sistemit te planifikimit të Integruar; Monitorimi i Programit Buxhetor Afatmesëm; Hartimi i Strategjive (Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim SKZHI 2014-2020); Menaxhimi i kontrollit financiar, rrishtu dhe gjurma e auditit ; Menaxhimi i politikave publike; Kostimi i strategjive etj.

Në tërësi, në fushën e menaxhimit financiar dhe planifikimit strategjik, janë zhvilluar 37 kurse trajnimi dhe janë trajnuar 984 nëpunës civilë.

Një risi e këtij viti ishte dhe organizimi i trajnimeve për nëpunësit e administratës tatimore dhe doganore. Këto trajnime u organizuan në bashkëpunim me Akademinë Fiskale Shqiptare. Gjatë kësaj periudhe u trajnuan 250 nëpunës të kësaj administrate kryesisht në trajnime që lidhen më nivelin e prezantimit me këtë administratë, hartuar për nëpunës të sapoemëruar.

Grafikisht pasqyra përmbledhese e trajnimeve të organizuara jepet nga diagram më poshtë.



Adresa: **Bulevardi Zhan D'Ark Nr 31, Tiranë**

Tel/Fax: +355 4 2271860

www.aspa.gov.al email: aspa@aspa.gov.al

📍 Indikatorët e trajnimit për periudhën Janar- Dhjetor 2014

Treguesit	
Numri i Kurseve	158
Ditë trajnimi të Zhvilluara	532
Pjesmarrës në trajnim	3718
Indikatori i Trajnimit: Nëpunës Civil x Ditë trajnimi	12522
Indikatori i Cilësisë së Trajnimit (shkallë 1-6)	5.7

📍 Mbështetje Institucionale dhe Financiare

⇒ Departamenti i Administratës Publike (Ministria e Brendshme)

Departamenti i Administratës Publike ka miratuar në vijimësi planin e punës dhe programin e trajnimit dhe ka ndjekur veprimtarinë trajnuese të Institucionit duke dhënë sipas rastit, orientimet dhe udhëzimet e duhura.

⇒ Këshilli Drejtues i ASPA

Këshilli drejtues, i ASPA-s si organ vendim marrës ka një rol shumë të rëndësishëm për mbarëvajtjen e punës në ASPA. Ai përbehet nga 12 anëtare dhe kryesohet nga Z. Jorgaq Kacani, i emëruar nga Konferenca e rektorëve. Gjatë vitit 2014, u zhvilluan 3 mbledhje të Këshillit Drejtues dhe u miratua “ Rregullorja e funksionimit të Këshillit Drejtues”. Ndërkohë është në proces edhe miratimi disa dokumentave bazë si Rregullorja e funksionimit të ASPA-s, Procedurat e organizimit të trajnimeve në ASPA . Duke qënë një organ i përbërë nga përfaqësues të Kryeministrit, Ministrive të Linjës, botës akademike, shoqërisë civile dhe pushtetit vendor, Këshilli Drejtues është një aset i rëndësishëm dhe shumë vlefshëm i cili e drejton ASPA-n në realizimin e detyrave dhe angazhimeve të saj.

📍 Donatorë dhe bashkëpunime me projekte

➤ Delegacioni i Bashkimit Europian

Shkolla Shqiptare e Administratës Publike, ka vazhduar bashkëpunimin me Delegacionin e Bashkimit Europian edhe gjatë vitit 2013-2014. Është nënshkruar memorandum mirëkuptimi me dy projekte të financuara nga Delegacioni i Bashkimit Europian në Tiranë, siç janë projekti PPF, e SMEI III në Ministrinë e Integritimit Europian me të cilat ka bashkëpunuar me sukses gjatë kësaj periudhe.

Në Bashkëpunim me projektin PPF (Project Preparation Facility) dhe SMEI III, janë zhvilluar trajnime me tematika si: Menaxhimi i ciklit të projektit dhe kuadri logjik, Hartimi i termave të referencës; Zbatimi i projekteve të financuara nga BE, Procedurat e prokurimit (PRAG) sipas standardeve të BE; Monitorimi i programeve të financuara nga BE; Politikat Sociale dhe punësimi kap 19; Menaxhimi financiar dhe kontrolli i brendshëm ; Bujqësia dhe zhvillimi rural kapitulli 11; Monitorimi i projekteve të financuara nga



Adresa: **Bulevardi Zhan D'Ark Nr 31, Tiranë**

Tel/Fax: +355 4 2271860

www.aspa.gov.al email: aspa@aspa.gov.al

BE; Levizja e lirë e punëtorëve Kapitulli 2; E drejta e pronësisë intelektuale kapitulli 7, etj. Grupi i synuar i këtyre trajnimeve kanë qënë nëpunës civilë të administratës qendrore dhe kanë shërbyer për aftësimin e administratës publike, për ta bërë atë më eficiente.

Këshilli i Europës:

Një vend të rëndësishëm kanë zënë trajnimet që u organizuan me mbështetjen e SIGMA-s, lidhur me ligjin 152/2013 “ Për nëpunësin civil”. *U zhvilluan 6 trajnime 2 ditore dhe u trajnuan 214 nëpunës civilë në nivel qendror*. Ndërkohë vlen të theksohet se në vazhdimësi, kjo kurrikul është bërë pjesë e trajnimit “Prezantim me administratën publike” dhe zhvillohet nga trajnerët e përgatitur nga ky bashkëpunim.

Shkolla Shqiptare e Administratës Publike në kuadër të programit TAIEX, zhvilloi në datat **19-23 Maj 2014**, aktivitetin “Expert Mission Training Programmes for Senior Managers”. Objektivi kryesor ishte rritja e kapaciteteve të stafit të ASPA-s me qëllim rritjen e cilësisë së shërbimeve që ajo ofron, në përputhje me nevojat reale të administratës publike shqiptare.

Objektivat specifike të këtij aktiviteti ishin:

- Njohja e metodologjisë për analizën e nevojave për trajnim për menaxherët e niveli të lartë;
- Asistencë për menaxherët e trajnimit të ASPA-s, në hartimin kurrikulës së trajnimit për këtë nivel nëpunësish;
- Krijimin e burimeve të trajnimit (siç janë dokumente ose materiale, raste studimore etj);
- Krijimin e burimeve të nevojshme për e-learning ;

Po në kuadër të këtij bashkëpunimi, në **datat 29-30 Maj 2014**, u zhvillua workshop-i me temë: “Rritja e kapaciteteve të stafit manaxherial në lidhje me metodologjinë e trajnimit dhe vlerësimin e procesit të trajnimit . Objektivat kryesore të këtij aktiviteti ishin :

- Asistencë për menaxherët e trajnimit në hartimin e kriterëve, standardeve dhe rregulloreve të brendshme të institucionit;
- Eksperienat e vendeve të tjera europiane në këtë fushë;
- Hartimi i një manuali për ekspertët;
- Vlerësimi on-line i procesit të trajnimit, dhe i ndikimit të tij në rritjen e cilësisë së punës së Administratës Publike.

➤ **Bashkëpunimi me OSBE**

Mbështetja e Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASPA) nga OSBE-Prezenca në Shqipëri, ka synuar krijimin e një programi gjithëpërfshirës mbi çështjet e etikës e antikorrupsionit për vlerësimin e kurrikulës aktuale dhe impaktin e programit të trajnimit me synim ndërtimin e një programi trajnimi për



Adresa: **Bulevardi Zhan D'Ark Nr 31, Tiranë**

Tel/Fax: +355 4 2271860

www.aspa.gov.al email: aspa@aspa.gov.al

grupe interesi të niveleve të ndryshme në administratën publike dhe zhvillimin e Termave të Referencës për këtë kurs trajnimi.

Për arritjen e këtij objekti, Prezenca e OSBE-së kontraktoi dy konsulentë afat-shkurtër në periudhën 7 Nëntor 2013 - 7 Shkurt 2014; një konsulent ndërkombëtar dhe një konsulent vendas, të cilët asistuan Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASPA), me qëllim vlerësimin e situatës aktuale të kurseve me tematikë anti-korrupsionin dhe ngritjen e një programi trajnimi.

Në periudhën nëntor-dhjetor 2013 nga ana e ASPA, OSBE dhe dy ekspertëve u mundësua një seri aktivitetesh të cilat synuan:

- Analizimin e kuadrit ligjor lidhur me antikorrupsionin duke përfshirë etikën, parandalimin e konfliktit të interesit, të drejtën e informimit;
- Studimin dhe vlerësimin e kurrikulave të kurseve të trajnimit të përdorura deri tani si: “Etika dhe antikorrupsioni”, “E drejta për t’u informuar”, “Prokurimi publik me mjete elektronike”, “Parandalimi i konfliktit të interesave” dhe vlerësimin e impaktit të trajnimit tek pjesëmarrësit;

Për këtë qëllim janë organizuar një sërë takimesh me përfaqësues të - Departamentit të Administratës Publike (DAP), Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASPA), Inspektoriatit të Lartë të Deklarimit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI), Agjensinë e Prokurimeve Publike (APP), Komisionerin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KMDP), Avokati i Popullit; *ekspertë* trajnerë të fushës së etikës dhe antikorrupsionit si edhe me *organizata ndërkombëtare* si: Këshilli i Evropës (KIE), UNDP dhe USAID, etj.

Projekti në vazhdimësi për vitin 2014 pati rëndësi të veçantë për Shkollën Shqiptare të Administratës Publike pasi solli si produkte një kurrikulë të re, zhvillimin e termave të referencës, si dhe një program trajnimi lidhur për çështje që kanë lidhje me antikorrupsionin.

➤ **Global Opportunities Albania:**

- a) Shkolla Shqiptare e Administratës Publike, me financimin e OJF-Global Opportunities Albania (GOA) dhe Fondacionit Hanns Seidel Stiftung, në datën 20 Qershor 2014 organizoi tryezën me temë “Strategjia e Shkollës Shqiptare të Administratës publike në kuadër të strategjisë të reformës në administratën publike”. Qëllimi i këtij aktiviteti ishte rritja e kapaciteteve dhe motivimi i punonjësve të ASPA-s; Strategjia e trajnimit të ASPA –s si edhe plani i veprimit për të ardhmen. Gjatë kësaj tryeze, stafi i ASPA dhe të ftuarit e tjerë në këtë aktivitet prezantuan dhe më pas diskutuan sfidat më të cilat ASPA do të përballet në realizimin e objektivave si edhe domosdoshmërinë e bashkëpunimit dhe bashkërendimit të veprimtarive të saj, me aktorë të tjerë.
- b) Në kuadrin e rritjes së kapaciteteve të burimeve njerëzore të administratës publike, Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA), nën kujdesin e Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike si dhe me mbështetjen e Fondacionit Hans Seidel dhe Global Opportunity Albania, organizoi tryezën e rrumbullakët me temë “Trajnimi si instrument për rritjen e kapaciteteve të administratës publike”. Qëllimi i këtij takimi ishte përmirësimi i kurrikulës së trajnimit si dhe përzgjedhja e metodologjisë së trajnimit, për nëpunës të nivelit të lartë dhe të mesëm drejtues të administratës publike. Në përfundim të tryezës u nxorrën konkluzionet dhe rekomandimet për fushat e trajnimeve në Shkollën shqiptare të Administratës Publike :
 - I. *Aftësi të menaxheriale.* Tematikat e përfshira në këtë fushë janë, i) Menaxhimi publik (Roli i menaxherit në Administratën Publike, lidhshmëria, Delegimi, vlerësimi i performancës individuale, menaxhimi i sfarit/njesisë, motivimi, etika në komunikim, hartimi i dokumentave zyrtare.



Adresa: **Bulevardi Zhan D'Ark Nr 31, Tiranë**

Tel/Fax: +355 4 2271860

www.aspa.gov.al email: aspa@aspa.gov.al

- II. *Aftësitë teknike:* këtu përfshihen, ligji për shërbimin civil, procedurat dhe vendimarrja administrative, menaxhimi i financave publike dhe administrimi financiar, Bashkimi Evropian (histori/strukturat/institucionet).
- III. *Politikbërja:* këtu përfshihen, menaxhimi i politikave, vendosja e objektivave, monitorimi, raportimi.

➤ **PPF (Project Preparation Facilities)**

Edhe gjatë vitit 2014, vazhdoi bashkëpunimi midis Shkollës Shqiptare të Administratës Publike dhe projektit PPF (Project Preparation Facilities) financiar nga Bashkimi Evropian .

Në kuadër të këtij bashkëpunimi janë zhvilluar trajnimet me tematika si më poshtë:

1. Menaxhimi i ciklit të projektit - trajnim 3 ditor;
2. Menaxhimi i parregullsisve dhe riskut- trajnim 3 ditor;
3. Hartimi i Termave të Referencës për projektet e financuara nga BE-trajnim 2 ditor;
4. Menaxhimi financiar dhe kontrolli i brendshëm për fondet IPA-trajnim 3 ditor;
